

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“GROTEX ALBANIA” SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më date 26.10.2023 une, i nenshkruari:

**Nazmi Grori**, I lindur me 13.02.1962 ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me nr. identifikimi 027245907,

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

**“GROTEX ALBANIA” SHPK**

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare”

**Neni 2: Selia**

Selia e shoqërisë do të jetë:

**Durres, Lagjja 17, Rruga Rinia Durrsake, Zona Kadastrale 8517, Godine 3 kateshe me numer pasurie 171/380**

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

**Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si vijon:

- Tregtim me pakice e shumice, Import- eksport te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, blegtorale, bujqesore, pije te

ndryshme, artikuj higjeno-sanitare, detergjente, artikuj shtepiake e produkte te konsumit te gjere, lendeve te para, mobileri e pajisje zyrash, pajisje makineri, automjeteve e pjeseve te kembimit per makina te te gjitha tonazheve, cigare, medikamente mjeksore, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitare, hidraulike, duralumini, pllaka te te gjitha llojeve, plastikes, gomes, bimeve mjeksore, lendes drusore e mobiljeve, makinave te te gjitha llojeve e tonazheve, te linjave te prodhimit dhe te perpunimit, konfeksioneve e veshjeve te ndryshme, produkteve kozmetike e te parfumerise, etj.

- Prodhimin , tregtimin, import- eksport te konfeksioneve ne pergjithesi per burra, gra dhe femije, ne stofra ose sistetike, lekure ose te ngjashme brenda dhe jashte vendit, te linjave te prodhimit te konfeksioneve si dhe import-eksportin e tyre.
- Transport mallrash brenda dhe jashte vendit per vehte per te trete e me qira.
- Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është 100.000(njeqindmije) lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**Nazmi Grori** është zotërues i 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 100.000 leke.

### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë Nazmi GRORI për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

NAZMI GRORI

